



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

**DH.Shk II.nr. 1712/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., me NRB: 70465104, me seli në Mitrovicë, rr. "Vëllezërit Dragaj", p.n., kundër debitorit "Edona Group" Sh.P.K, me NUI: 811272096, me seli në Vushtrri, rr. "Hamit Hyseni", me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2612/22 të datës 29.09.2023, me datë 11.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2612/22 të datës 29.09.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2612/22 të datës 29.09.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit "Edona Group" Sh.P.K., ndërsa është anuluar urdhri përmbartimor P.nr.1026/22 i datës 24.08.2022, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa dhe është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të vërtetimit të gabuar gjendjës faktike, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të mirret një aktvendim meritor.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka kërkuar që të refuzohet ankesa e kreditorit si e pa bazuar dhe të vërtetohe aktvendimi i ankimuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., me dt. 24.8.2022, ka paraqitur propozim për përmbirim në bazë të dokumentit të besueshëm— Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit nr. VU.B.40.4267 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin t'ia paguajë kreditorit shumën prej 1,130.36 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit duke e llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbirimor duke theksuar se dokumenti i besueshëm nuk ka tipare të përmbirueshmërisë pasi që i njëjti është i paqartë dhe i pasaktë. Ka shtuar se nga viti 2019 debitori ushtron aktivitetin biznesor dhe të gjitha shpenzimet për mbeturina i ka të paguara dhe atë gjithsej 2686.05 euro, ndërsa borxhi i faturuar është 2789.40 euro, dhe se borxhi i cili kërkohet nga debitori është i bartur nga një biznes tjetër. Tutje thekson se kreditori për vitin 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, nuk mund të kërkojë përmbushjen sepse janë parashkruar, ndërsa periudha nga 2019 deri më sot janë ligjërish të kërkueshme. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri i përmbiruesit privat Atip Mustafa P.nr.1026/22 i datës 24.08.2022 dhe të obligohet kreditori që t'i paguaj shpenzimet e procedurës përmbimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor përmes të autorizuarit të tij ka deklaruar se kreditori ka paraqitur propozimin për përmbirim duke u bazuar dhe mbështetur në dispozitat e nenit 21 të Ligjit për Procedurën, ku përcaktohet qartë se procedura përmbimore

mund të zhvillohet vetëm në bazë të dokumentit përbarues apo titullit ekzekutiv. Ka shtuar se në rastin konkret procedura përbarimore ka filluar dhe është bazuar në faturat apo ekstraktet e kreditorit e të cilat përmbajnë të gjitha të dhënat e sakta lidhur me debitorin duke u bazuar dhe u mbështetur në frymën e nenit 40 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që urdhri për përbarim të mbetet në fuqi, ndërsa prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2612/22 të datës 29.09.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit “Edona Group” Sh.P.K., ndërsa është anuluar urdhri përbarimor P.nr.1026/22 i datës 24.08.2022, i lëshuar nga Përbaruesi Privat Atip Mustafa dhe është përfunduar në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist nr. VU.B.40.4267, mbi të cilin mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është krijuar dhe është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitori.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate qartë konstatohet se përbarimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, nga e cila faturë gjeti se borxhet të cilat janë akumuluar në fund të secilit nga vitet: 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, janë bartur në vitin pasues, duke e faturuar të njëjtin si borxh të ri andaj, nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është krijuar dhe është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitori.

Andaj, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe

gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por të njëjtat mbesin të pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht të vlefshme dhe se nuk kishin në ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarimore dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II nr.1712/23 me datë 11.04.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija- Ymeri